



A.nr.718/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.718/2026, të datës 30.06.2026, të parashtruar nga ankuesi A.M nga Klina, kundër organit të punësimit/Komunës së Klinës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.07.2026, nxjerrë, këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.718/2026, të datës 30.06.2026, të parashtruar nga ankuesi A.M.

A r s y e t i m

Ankuesi A.M (*tutje referuar ankuesi*), më datë 30.06.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 30.06.2026, për refuzimin e aplikacionit, lidhur me konkursin me Nr.Reference: RN00019790 për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit pozita *Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit* të shpallur nga Komuna Klinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 01.07.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunë të Klinës, ndërsa, Komuna e Klinës, më datë 03.07.2026, i ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të çështjes ka konstatuar se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se Komuna e Klinës, më datë 21.05.2026, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00019790 për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit pozita *Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit*, me afat aplikimi nga data 22.05.2026 deri më datë 20.06.2026.

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës del së në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo, sipas Vendimit 02Nr.111-13593/2026, të datës 30.06.2026 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës, të njëjtit i është refuzuar aplikacioni, me arsyetimin se nuk posedon drejtimin e përgatitjes adekuate për këtë konkurs.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton Vendimin 02Nr.111-13593/2026, të datës 30.06.2026 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës, duke pretenduar se në aplikacion ka bashkangjitur diplomën e studimeve Master në Menaxhim Mjedisi, i cili i përket fushës së mjedisit, pra pretendon se plotëson kërkesat e konkursit dhe refuzimi i aplikacioni është bërë pa të drejtë. Kërkon që aprovet ankesa, të konstatohet se vendimi për refuzim të aplikacionit është marr pa një bazë juridike dhe pa vlerësim të plotë objektiv, dhe të obligohet institucioni të rivlerësoj aplikacionin në përputhje me kriteret e konkursit duke marr në konsideratë diplomën e studimeve master.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht, nenit 39, paragrafi 12 i cili përcakton se: *“12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”*, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil parashihet se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankuesit e parashtruar më datë 30.06.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër vendimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankuesit të datës 30.06.2026, nuk kishte përfunduar procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00019790 për pozitën *Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit*, rrjedhë se ankesa e ankueses A.nr.718/2026, e datës 30.06.2026 është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 17 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.718/2026 nuk mohon të drejtën e ankuesit që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda;A.nr.718/2026, datë 21/07/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.M;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.